



ZONA FIORENTINA SUD EST/ZONA JUGLINDORE E FIRENCES
Komunat e Bagno a Ripoli, Barberino Tavarnelle, Fiesole, Figline Incisa
Valdarno, Greve in Chianti, Impruneta, Londa, Pelago, Pontassieve, Reggello,
Rignano sull'Arno, Rufina, San Casciano Val di Pesa, San Godenzo

MASAT E JASHTËZAKONSHME NË MBËSHTETJE TË PAGESËS SË QERASË PAS
VËSHTËRËSIVE TË KRIJUARA NGA EMERGJENZA COVID-19

Ç'farë është

Familjet që, për shkak të emergjencës COVID 19, janë në gjendje të rëndë ekonomike, mund të kërkojnë kontributin e jashtëzakonshëm për punëtorët (punonjësit dhe të vetëpunësuarit) të cilët, si pasojë e emergjencës epidemiologjike nga Covid-19, kanë pushuar, zvogëluar ose pezulluar veprimtarinë e punës ose marrëdhënien e tyre të punës dhe që gjenden në vështirësi për pagimin e qirasë..

Si mund të paraqisni kërkesën

Kërkesa për pjesëmarrje duhet të paraqitet duke hyrë në faqen e internetit të Komunës së vendbanimit në mënyrën e treguar nga secila komunë, duke filluar **nga dita e enjte 23 prill deri në orën 23,59 të 13 maj 2020.**

Kush mund të aplikojë

Për të përfituar kontributin është e nevojshme që:

- a) **Të jeni rezident** i Komunes së _____ në banesën për të cilën paguhet qiraja;
- b) **të keni një kontratë të rregullt qiraje** për përdorim banimi, të regjistruar rregullisht, duke iu referuar banesës në të cilin keni vendbanimin tuaj;
- c) Të mos keni (pronë apo banesë në përdorim), ndonjë banesë tjetër të përshtatshme për nevojat e familjes, e cila ndodhet në një distancë prej 50 km ose më pak nga komuna ku paraqitet kërkesa..
- d) Të keni një I.S.E. (Treguesi i Situatës Ekonomike), **jo më i lartë se Euro 28.684,36** për vitin 2020. Nëse aplikuesi nuk ka akoma çertifikatën 2020 mund të shënojë në kërkesë Deklarimin e të ardhurave 2020 duke treguar Protokollin INPS. Përndryshe, ju mund të paraqisni çertifikatën I:S:E të vitit 2019;
- e) Të keni patur një **reduktim të të ardhurave familjare në masën jo më pak se 30%** (tridhjetë përdind) **për shkaqeve që i atribuohen emergjencës epidemiologjike nga Covid-19 e llogaritur duke krahasuar të ardhurat totale të familjes për muajin Mars 2020, në krahasim me të ardhurat totale për muajin Mars 2019.**

Kjo rënie mund të referohet si në të ardhurat e punonjësve (ulje të orarit të punës, pushime nga puna, etj.), ashtu edhe të ardhura nga vetëpunësimi (me referencë të veçantë për kategoritë ATECO, veprimtaria e të cilave është pezulluar ose zvogëluar pas masave të qeverisë), si dhe për të ardhurat nga puna me kontrata jo të përhershme të çdo lloji;

Kush është i përjashtuar nga kontributi

a) Ky kontribut nuk mund të kombinohet me kontributin për autonominë e të rinjeve nga Masa GiovaniSi në lidhje me qiranë për strehim të pavarur të dhënë për vitin 2020;

b) Nuk mund të marrin këtë kontribut ato famije që kanë me qira banesat e konunës / “Edilizia Residenziale Pubblica” (E.R.P.)

Kriteret për formimin e renditjes (graduatoria)

Renditja do të formohet bazuar në atribuimin e pikëve të mëposhtme:

PIKËT PËR VLERËN I.S.E. PËR VITIN 2019

Vlera I.S.E. nga € 0,00 deri € 6.700,00	Pikë 4
Vlera I.S.E. nga € 6.700,01 deri € 13.400,00	Pikë 3
Vlera I.S.E. nga € 13.400,01 deri € 20.000,00	Pikë 2
Vlera I.S.E. nga € 20.000,01 deri € 28.684,36	Pikë 1

PIKËT NË LIDHJE ME REDUKTIMIN E TË ARDHURAVE PËR SHKAK TË EMERGJRENCËS NGA COVID-19 NË MUJIN MARS 2020 NË KRAHASIM ME MARSIN E 2019

Reduktim i të ardhurave nga 30% deri 40%	Pikë 1
Reduktim i të ardhurave nga 41% deri 60%	Pikë 2
Reduktim i të ardhurave nga 61% deri 80%	Pikë 3
Reduktim i të ardhurave nga 81% deri 100%	Pikë 4

PIKËT PËR PREZENCËN E TË MITURVE e PJESËTARË TË PAAFTË NË FAMILJE

Për secilin të mitur të pranishëm në familje	Pikë 0,3
Për secilin person me aftësi të kufizuaratë barabartë apo më të madhe se 67% në familje në pajtim me L. 5/2/1992, n. 104	Pikë 0,3

Shuma e kontributit

Kontributi i kësaj Mase të jashtëzakonshme do të mbulojë 50% të qirasë dhe, në çdo rast, në një masë që nuk tejkalon 300 € / muaj. Kontributi korrespondon me 3 muaj pasues duke filluar nga Prilli 2020 dhe do të paguhet pas miratimit të renditjes përfundimtare.

Kontributet do të paguhen në renditjen së graduatores deri në kufirin e burimeve të disponueshme dhe do të paguhen me transferim bankar.

Paralajmërimet

Fituesit e këtij Kontributi mund të marrin pjesë e të paraqesin kërkesën edhe në Garën e kontributit të qirasë për vitin 2020 (dalja parashikohet në qershor/korrik). Shuma që do merrni me këtë kontribut si masë e jashtëzakonshme do t'ju zbritet nga kontributi i qerasë që ju takon në bazë të Garës për vitin 2020.

Renditja e fituesve dhe lista e të përjashtuarve do të publikohen në formë anonime në bazë të normativës në fuqi mbi fshehtësinë etë dhënave.

Dokumente që duhen bashkëngjitur kërkesës

TË DETYRUESHËM

- Kopja e dokumentit të identitetit të personit që paraqet kërkesën;

JO TË DETYRUESHËM

- Kopja e kontratës së qirasë (nëse nuk është e depozituar pranë Komunës për kontributin e qerasë për vitin 2018/2019);
- Dokumentët në lidhje me reduktimin apo pezullimin e aktivitetit të punës;
- kopje e vërtetuar e dekretit të ndarjes ose shkurorëzimit.
- dokumentacion që vërteton titullin e pro-kuotës së të drejtave reale mbi pronën, apo dokumentet që vërtetojnë se prona nuk është në dispozicion të familjes;
- dokumentacion që vërteton aftësinë e kufizuar ose invaliditetin.